

Faleminderit!

Para se të nis fjalën time, meqenëse zonja Dhima sfidoi kolegun nga Lushnja, do të doja ta pyesja: kur patët rastin e njërit prej të afërmeve tuaj, sa e paguanit infermierin që merrnit në shtëpi? Pse morët në telefon ministren që t'u siguronte një mjek? Sepse askush nuk po kujdesej për të? Kjo është shëndetësia që ju e ngritët aq lart. Ju kishit akses te ministrja dhe ndaj mundët të siguronit shërbimin shëndetësor. Jeni bërë krejt të pabesueshëm, qesharakë dhe na kujtoni fjalimet e kryetarëve të kooperativave në kohën e socializmit. Të nderuar qytetarë, Përpara se të mbaj qëndrimin në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për marrëveshjen me Pfizer-in, kam një thirrje për të gjithë ata që janë të pavaksinuar: ju lutem, vaksinohuni! Jo me detyrim, jo sepse ju thotë qeveria, ministria, Kryeministria, por sepse është më e mira për ju. Unë vetë deri para disa ditëve kisha ende nivel të lartë të antitropave pas Covid-it, por sapo analizat treguan që niveli i antitropave ishte reduktuar ndjeshëm, menjëherë bëra vaksinën. Pak dhimbje krahu, pak dhimbje koke, por gjithçka e përballueshme. Ju lutem, vaksinohuni, sepse vaksina mbron jetën, ju mbron ju dhe familjet tuaja.

Qeveria e Shqipërisë është e vonuar në këtë drejtim. Edhe marrëveshja e sotme, të cilën ne e kemi miratuar në çdo komision dhe sot do të japim votën pro për të, është e vonuar, madje është shumë e vonuar. Procesi filloi me vonesë, vijoi me vonesa, pa transparencë, pa fushata sensibilizimi apo informimi, ndaj dhe sot vijon me mashtrime dhe manipulime shifrash. Manipulojnë shifrat e vaksinimit, siç kanë bërë me ato të vdekjeve nga Covid-i, të të prekurve, të të kuruarve, të të shpëtuarve, siç bëjnë me fondet, kurat, ilaçet, tenderët sekretë, prokurimet abuzive. Gjithçka pa transparencë dhe pa detyrimin për të informuar publikun. A ju kujtohet ministrja Manastirliu kur s'përmbahej nga admirimi për Kryeministrin e saj, që, si asnjë kryeministër në botë, priti valixhen e vogël me 900 vaksinat e para të Pfizer-it? Më tej ky ritual u përsërit çdo javë. E mbani mend ministren kur tha që po nis një epokë e re? Vaksinimi "the game changer", tha ministrja. Kjo është ta shfrytëzosh vaksinimin për propagandë elektorale, kjo është që të shfrytëzosh vdekjet për politikë. Por ja që edhe që në epokën e re të Manastirliut Shqipëria mbeti e parafundit në rajon për vaksinimin. Ja ku janë shifrat, jo të opozitës, as ato që përgatit me kujdes ministrja në zyrat e propagandës së Partisë Socialiste. Këto janë shifrat zyrtare dhe është i njëjti standard për të gjithë botën. Kam një pyetje, zonja Ministre. A nuk ju vinte pak zor kur bridhnit nga një komision në tjetrin duke manipuluar shifrat e vaksinimit? 28,4% është niveli i vaksinimit. Ja ku është Shqipëria, e parafundit në rajon. As 1/3-ta e popullsisë nuk është vaksinuar, kurse në komision thoshte që ndihej krenare. Për çfarë ndiheni krenare, që jemi të parafundit në rajon për nivelin e vaksinimit, ndërkohë që niveli i Bashkimit Europian, dhe po flas për të dyja dozat, është 63%, kur në të gjithë Europën është 52%? Jemi shumë poshtë edhe nivelit të përgjithshëm botëror, duke përfshirë edhe vendet afrikane, i cili është 34%. Në rajon jemi të parafundit. Serbia e ka nivelin e vaksinimit 42%, Kosova 31%, Mali i Zi 34%, Maqedonia e Veriut 35%. Këto janë shifra dhe jo opinione, ashtu sikurse pretendon ministrja. Partia Demokratike i ka kërkuar qeverisë në mënyrë të vazhdueshme të marrë të gjitha masat për të përballuar Covid-in. Madje, duke e tejkaluar edhe rolin tonë si opozitë, i ofruam qeverisë dy herë plane konkrete, masa konkrete, kosto konkrete. Një qeveri e përgjegjshme do t'i ishte përgjigjur me pozitivitet, do të kishte reaguar, por jo kjo jona, që nuk është në shërbim të qytetarëve, por të pushtetarëve, oligarkëve, që e lanë vendin shumë muaj si han pa porta. Zonja Ministre, ju lutem, po flas për ju ! Shqipëria është i

vetmi vend në Europë që pranonte deri para pak ditësh çdo njeri nga çdo vend, edhe nga India, apo Pakistani, pa test PCRje, pa certifikatë vaksinimi. Ende sot Shqipëria nuk ka një Passenger Locator Form PLF, që na e kërkon sa herë dalim nga Shqipëria. Askush nuk e di kush hyn në Shqipëri, ku shkon dhe ku karantinohet, nëse. Pse as Klodiana dhe as një mjek deputet nuk foli kur pacientëve me sëmundje të ndryshme iu refuzua kura, sepse spitalet publike reduktuan ndjeshëm numrin e operacioneve për shkak të Covid-it apo sepse u kthyen në spitale Covid? Pacientë me sëmundje tumorale apo sëmundje të tjera janë ende sot pa u kuruar.

Një miku im, mjek primar në një nga spitale të njohura në Europë, më tha pak ditë më parë që kthimi i spitaleve kirurgjikale në spitale Covid mund të konsiderohet nga ne mjekët edhe krim në shëndetësi. Duke vonuar operacionet e tyre, është një lloj sikur t'i vrasësh ata. Të nderuar qytetarë, Të gjitha raportet e fundit ndërkombëtare nxjerrin zbuluar dështimet e qeverisë. Komisioni Europian publikoi raportin e RCC-së, ku vdekjet shtesë në Shqipëri gjatë vitit 2020 ishin 27,1%, 16000 më shumë, më shumë se dyfishi i mesatares së Bashkimit Europian. Ky është krim dhe për këtë nuk është ndëshkuar askush deri tani dhe përgjegjësi direkte mban ministrja. Eurostat-i dhe INSTAT-i treguan se rritja e vdekjeve në Shqipëri ishte më e larta në Europë. Vdekjet në 54 javë pandemi, nga 2 marsi 2020 deri më 15 mars 2021, u rritën me 41%. Gjatë pandemisë shëndetësia falas u shndërrua në tmerrin falas për pacientët e familjarëve që nuk kishin asnjë mundësi për të mbuluar kura apo ekzaminime. Shoqata "Together for life" raporton se në Shqipëri nga 164000 pacientë me COVID të regjistruar në sistem, por që ka shumë më tepër që nuk janë regjistruar, vetëm 7000 prej tyre mund të rimbursoheshin. Çdo pacient ka paguar 1000 dollarë mesatarisht, por vetëm 40 dollarë i janë rimbursuar. Po pjesa tjetër?! Pacienti ose ka humbur jetën, ose i është dashur të marrë borxh. Anketa e Buxhetit të Familjes e INSTAT-it nuk po jua mbulon dot dështimin. Dy ditë më parë ajo tregoi që familjet shqiptare shpenzuan mesatarisht 51500 lekë në muaj për shëndetësi, 28% më shumë se një vit më parë, thënë ndryshe 392 milionë euro, pothuajse aq sa ka paguar buxheti i shtetit. Kjo është një shifër tronditëse e dhënë nga INSTAT-i. Të dhënat e fundit të Eurostat-it tregojnë se 380 mijë qytetarë, 13,5% e totalit, nuk i përballojnë dot çmimet e larta të kurave dhe të ekzaminimeve. Amulli totale! Nisja e vitit të ri shkollor shtyhet dy herë pa asnjë arsye, pa një studim apo analizë. Viti i ri akademik u shty dje pa asnjë shpjegim. Askush nuk diskuton dhe askush nuk informon për këtë. Anketa e fundit e portalit studentor tregon se 66% e studentëve janë të pavaksinuar, por 74% e tyre duan mësim në auditor. Pse ndodh kjo?! Sepse ju nuk uleni, nuk diskutoni dhe nuk i informoni studentët.

Të nderuar qytetarë,

Partia Demokratike ka dorëzuar në SPAK 3 kallëzime penale për përfshirjen e ministres Ogerta Manastirliu në krime elektorale dhe, më skandalozja, në mes të pandemisë. Gjatë muajve mars-prill, në vend që ministrja të ishte në detyrën e saj, ju e kuptoni që ishte mesi i pandemisë, të rrinte në zyrën e saj dhe të menaxhonte pandeminë, ajo bridhte shtëpi më shtëpi, duke përhapur virusin, me tamponë, me kura, me certifikata legalizimesh në dorë, si dhe me punësime elektorale, ndërkohë që të sëmurët rëndë qëndronin mbi 10 orë para spitaleve COVID, duke shkaktuar edhe humbjen e jetës së pacientëve. Kam dorëzuar në SPAK edhe fotot e shtëpive ku ka qenë ministrja me certifikatat e legalizimeve në dorë. Ministrja, të paktën në një akt moral përgjegjësie sot nuk duhet të ishte këtu, por duhet të kishte dhënë dorëheqjen dhe t'i kishte hapur rrugë drejtësisë. Ja ku e keni skemën e patronazhistëve, që ka ngritur Ogerta Manastirliu në njësinë nr. 9. Janë 674 patronazhistë; 50 mijë të patronazhuar, ku 70 prej tyre janë vartës të saj, janë doktorë, mjekë, infermierë dhe laborantë, të cilët, në vend që të merreshin me pandeminë, shkonin dhe bënin patronazhimin për Ogerta Manastirliun. Ky është krim elektoral i pahetuar ende nga SPAK-u. Në ditën e parë të punës së Komisionit Hetimor për Masakrën Zgjedhore do të dorëzoj pranë zotit Alibeaj të gjithë informacionin që kam, me emrat e çdo patronazhisti në njësitë ku unë kam kandiduar, njësitë 9 dhe 11, dhe do t'i

kërkoj t'i dorëzoj zotit Alibejaj, si kryetar i Komisionit Hetimor për Masakrën Zgjedhore, çdo informacionin që kam dhe do t'i kërkoj që të publikojë çdo emër patronazhisti, sigurisht duke respektuar legjislacionin. Skema monstruoze e patronazhimit, edhe e Ogerta Manastirliut, duhet shembur nga themelet. Askush nuk duhet të guxojë të bëjë patronazhistin apo të raportojë të dhënat personale të qytetarëve, aq më pak kur kanë të bëjnë me shëndetin apo jetën e tyre. Spitalet i latë me aparatura të amortizuara, ndërkohë që ministrja bënte edhe patronazhisten.

Të nderuar qytetarë,

Partia Demokratike është pro kësaj marrëveshje dhe çdo marrëveshjeje tjetër, ku garant janë kompani si Pfizer apo institucione serioze. Ne e konsiderojmë të vonuar dhe i kërkojmë qeverisë të marrë urgjentisht masat për t'i përshpejtuar ritmet e vaksinimit, si dhe duke shtuar fushatat informuese e sensibilizuese. Në këtë drejtim, çdonjëri prej nesh ka një rol dhe një detyrë morale: të shpëtojmë sa më shumë jetë! Faleminderit!